



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2019:108111
Datë: 26.01.2021
Numri i dokumentit: 01442668

C.nr.1112/18

GJYKATA THEMELORE NË PEJË - Gjyqtari Fatmir Baloku në çështjen juridiko-civile kontestimore të paditëses , rr. ”.....”, pn, me seli në, të cilën e përfaqëson e autorizuar Olumbie Haliti , kundër të paditurit Sh. (H.) M. nga fshati, K., baza juridike rimbursim i dëmit material dhe jomaterial, vlera e kontestit 88 euro (tetëdhjetë e tetë euro), pas përfundimit të seancës së shqyrtimit kryesorë me datë 26.01.2021, jashtë seancës me datë 26.01.2021, bie këtë :

A K T G J Y K I M

DETYROHET i padituri Sh. M. , që paditëses të i rimburojë shumën prej 88 euro (tetëdhjetë e tetë euro) në emër të rimbursimit të dëmit dhe atë me kamatë 8% nga dita e vendosjes (26.01.2021), e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës në shumën prej 20 (njëzetë) euro, e të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit të aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

A r s y e t i m

Paditësja me datën 12.10.2018, ka parashtruar padi me bazë juridike rimbursim i dëmit material dhe jomaterial , vlerë të kontestit 88.00 euro, kundër të paditurit Sh. M., duke kërkuar aprovim të kërkesëpadisë së paditëses, duke detyruar të paditurin të rimburojë shumën prej 88 euro (tetëdhjetë e tetë euro), në emër të rimbursimit të dëmit të shkaktuar në aksidentin e trafikut të datës 07.10.2013 në

Gjykata në afatin e paraparë ligjor i ka dërguar palës së paditur aktvendim për përgjigje në padi se bashku me padinë dhe te gjitha provat në mënyrë që të deklarohet për prapësimet procedurale dhe të deklarohet në lidhje me kërkesëpadinë, të cilat i padituri i ka pranuar me datën 18.12.2018 mirëpo i njëjti nuk ka parashtruar përgjigje në padi.

Në seancën e caktuar të datës 26.01.2021 ka prezantuar vetëm e autorizuar e palës paditëse, ndërsa i padituri nuk ka prezantuar ne seancë edhe pse njëjti ka qenë i njoftuar gjë qe vërtetohet nga fletëkthesa e nënshkruar nga i padituri me datën 22.12.2020.

Prandaj gjykata e seancën e ka mbajtur në mungesë të paditurit konform dispozitave të nenit 424 par 4 i LPK-së.

Në seancën e shqyrtimit dhe në fjalën përfundimtare e autorizuara e palës paditëse deklarojë se mbesin në tërësi pranë padisë dhe kërkesës së sajë duke i propozuar gjykatës të aprovojë padinë dhe kërkesëpadinë duke obliguar të paditurin të rimbursoj dëmin e shkaktuar në emër të rimbursimit të dëmit shumë prej 88euro (tetëdhjetë e tetë euro) dhe atë me kamatë sipas mjeteve të deponuara mbi një vit pa destinim të caktuar dhe duke llogaritur nga dita e ngritjes së kësaj padie deri në pagesën përfundimtare si dhe shpenzimet për taksë për padi në shumë prej 20 euro.

Për të vërtetuar gjendjen faktike gjykata në shqyrtimin kryesor ka administruar këto prova: transferi bankar i dt 04.05.2016, ujdia jashtëgjyqësorë nr 1658/15 dt 18.03.2016, raporti i aksidentit 07.10.2013 dhe aktvendimi nr.K.5-15542/13 i dt 24.03.2014 i Gjykatës Themelore në Pejë - Divizioni për Kundërvajtje.

Pas vlerësimit të provave veç e veç e të gjitha në lidhshmëri reciproke e në kuptim të nenit 8 të LPK-së, gjykata arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko - kontestimore duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e nga arsyet siç vijon :

Me datën 07.10.2013 në Pejë është shkaktuar aksident trafiku në të cilën ishin të përfshirë dy automjete , ashtu që deri tek aksidenti ka ardhur kur drejtuesi i automjeti A këtu i padituri Sh. M. nga pakujdesia i shkakton dëme të dëmtuarit H. D. këtë fakt e gjykata e ka vërtetuar nga raporti i aksidentit i policisë dt 07.10.2013

Nga ujdia jashtëgjyqësore e lidhur me datën 18.03.2016 në mes të paditëses dhe të dëmtuarit H. D., shihet se janë dakorduar që i dëmtuari të paguhet në emër të zhdëmtimit në shumë prej 88 euro, ashtu që nga transferi i datës 04.05.2016, vërtetohet se nga kontoja numër nga, në Bankën është bërë pagesa e lartcekur.

Detyrimi i të paditurit për rimbursim gjen mbështetje në dispozitat e nenit 18 par 4 të Ligjit për Sigurinë e Detyrueshme nga Autopërgjegjësia dhe nenit 245 të LMD-së.

Neni 18 par 1 i Ligjit për Sigurinë e Detyrueshme nga Auto përgjegjësia parasheh që ‘personi i dëmtuar të cilit i është shkaktuar dëmi brenda Republikës së Kosovës nga një mjet motorik, pronari i të cilës nuk është i mbuluar nga sigurimi i auto përgjegjësise, ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblimin e dëmit nga Byroja, e në këtë rast paditësja me provat e prezantuara dëshmon se ka bërë pagesën e dëmit të shkaktuar, duke përmbushur detyrimet e saj sipas par 2 i cili përcakton ‘në rast dëmi të shkaktuar nga mjete motorik sipas paragrafit 1 të këtij neni Byroja garanton detyrime në kuadër të limiteve të përcaktuara sipas nenit 13 Ligji për Sigurinë e Detyrueshme nga Autopërgjegjësia ‘.

Nga të lartcekurat më lartë paditësja ka të drejtë të kërkojë rimbursimin e dëmit material nga personi përgjegjës këtu i padituri Sh. M. duke u bazuar në dispozitat e nenit 18 par 4 i Ligjit për Sigurinë e Detyrueshme nga Autopërgjegjësia përcakton se ‘Byroja ka të drejtë

regresi për këto dëme nga personi përgjegjës dhe atë për shumën e paguar, shpenzimet dhe kamatat''.

Vendimi për kamatën është i bazuar në dispozitat e nenit 382 par 1 dhe 2 i LMD si dhe në mendimin juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës dt 01.12.2020 lidhur me kamatën dhe atë pjesa e dytë pika VI.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës gjykata e bazon në nenin 452 par 1 të LPK-së, duke aprovuar shumën prej 20 euro sa i përket taksës gjyqësore për padi.

Pasi që kemi të bëjmë me kontest të vlerë së vogël, gjykata në dispozitiv të këtij aktgjykimi vendosi që të detyrojë të paditurin që përmbushjen e detyrimit ta kryejë në afat prej 7 ditësh e konform dispozitave të nenit 491.4 të LPK-së, gjithashtu gjykata vendosi që kundër aktgjykimi palët mund të parashtrojnë ankesë brenda afati prej 7 ditësh e konform dispozitave të nenit 491.4 të LPK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PEJË datë 26.01.2021.

**Gjyqtari
Fatmir Baloku**

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa,
në afat prej 7 ditëve, nga dita e dorëzimit,
Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj gjykate.